



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 287, datë 17.12.2020

**PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË KANDIDATIT LORENC MERKURI PËR
NGRITJEN NË DETYRË NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË
PRANË GJYKATËS SË APELIT GJIROKASTËR**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në gjurmën “a” të pikës 6 të nenit 47, në pikën 9 të nenit 52, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gjurma “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në gjurmën “ç” të nenit 8 dhe në nenin 9 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me Vendimin nr.200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Ndalimin e kandidimit për kandidatin Z. Lorenc Mërkuri për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër.
2. Vendimit i bashkëngjitet relacioni shpjegues i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.
3. Të njoftojë Z. Z. Lorenc Mërkuri për këtë Vendim.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e njoftimit të Vendimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR

ALFRED BALLA

ANËTAR

KOSTAQ BELURI

ANËTAR

BUJAR SHESHI

ANËTAR

NURIHAN SEITI

ANËTAR

SANDËR BECI

ANËTAR

VATË STAKA

ANËTAR

TARTAR BAZAJ

ANËTAR

ESMERALDA KESHI